

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, Shpresa Hasaj – Hyseni, dhe Suzana Çerkini - anëtare, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit A.D., për shkak të veprës penale Mbjakta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë PP.nr.691-6/12 dt. 08.10.2012, pas shqyrtimit gjyqësorë me datë 14.12.2017, në të cilin të pranishëm ishin prokurori i shtetit – Valdet Gashi, dhe i pandehuri A.D., në të njëjtën ditë gjykata mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: A.D., i biri i I. dhe Z., e gjinisë G., i lindur me dt ... në fshatin V., KK F.K., ku edhe jeton, taksist, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i pesë fëmijëve, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me datën 24.08.2012, rreth orës 20:00 në oborrin e shtëpisë së vet në fshatin V., KK F.K., gjate ahengut familjar ka përdorur armën në mënyrë të paautorizuar duke shtënë tri here në ajër me pistoletën “CervenaZastava”, prodhim jugosllav me numër seril 252617.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbjakta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,49,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit **A.D.**, i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**, i cili nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej **1 (një) viti**.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohet:

Pistoleta “CervenaZastava”, prodhim jugosllav me numër serik 252617.

Arsyetim

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.nr.691-6/12 dt. 08.10.2012, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin A.D., për shkak të veprës penale Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së.

Me datë 14.12.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën gjyqësore në këtë çështje penale në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Valdet Gashi, dhe i pandehuri A.D.. Prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën PP.nr.691-6/12 dt. 08.10.2012, ndërsa Kryetari i Trupit Gjyqësor pasoi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri A.D., në shqyrtimin gjyqësorë e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë.

Prokurori i shtetit Valdet Gashi pas deklarimit të të pandehurit deklarojë se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Megjithatë i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: lista e armës se konfiskuar lëshuar nga stacioni policor në Fushë Kosovë nr 2012-AE-00923, dt. 23.08.2012, si dhe dokumentacioni tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

Gjykata pas marrjes së vendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, kalon në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit Valdet Gashi në fjalën e tij përfundimtare deklaroj: mbetet pranë akuzës së ushtruar me shkrim kundër të pandehurit A.D., ngase e njëjta është mbështetur në prova të mjaftueshme që vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë për kryerjen e veprës penale, kjo u vërtetua edhe me vet pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtim gjyqësor, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit, ku gjate matjes së dënimit gjykata si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

I pandehuri A.D. në fjalën e tij përfundimtare deklaroj: se ka gjuajtur me armë në aheng kur i ishte martuar djali i vëllait të tij, ka gjuajtur nga gëzimi, dhe më nuk ka përsëritur më vepra penale, duke theksuar se është hera e parë që gjendet para gjykatës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethanave çanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, rrethanat e tij familjare, gjendjen e tij të dobët ekonomike, dhe sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësorë, si dhe moshën e tij të thyer, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandalon të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandalon personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë në vështrim të nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikursenë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PNR. 770/12, datë 14.12.2017

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.